



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.34

2005

20 maj

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Dekret nr.4529/1 datë 8.4.2005	Për lejim lënie të shtetësisë shqiptare	1259
Vendim i KM nr.289, datë 15.4.2005	Për përcaktimin e kërkesave dhe të procedurave për miratimin e lejeve, të autorizimeve dhe të koncesioneve për përdorimin e ujit	1260
Vendim i KM nr.291, datë 6.5.2005	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.230, datë 22.7.1991 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e komisioneve të tokave”, të ndryshuar.....	1266
Vendim i KM nr.292, datë 6.5.2005	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.315, datë 23.6.2000 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin dhe funksionimin e Institutit të Trajnimit të Administratës Publike dhe trajnimit e nëpunësit civil”, të ndryshuar	1268
Vendim i KM nr.298, datë 6.5.2005	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore”, të ndryshuar.....	1269
Vendim i KM nr.299, datë 6.5.2005	Për fillimin e procedurës së ndërtimit me koncesion, të formës “BOT”, për ndërtimin e hidrocentralit të Skavicës, sipas propozimit të pakërkuar	1271

Vendim i KM nr.303, datë 6.5.2005	Për përcaktimin e shërbimit të gjendjes civile, si shërbim që jepet me koncesion	1271
Vendim i GJK nr.9, datë 9.5.2005	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr.2352, datë 26.5.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr.663, datë 26.5.2003 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.1286, datë 17.6.2004 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si antikushtetuese	1272
Vendim i GJK nr.10, datë 9.5.2005	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr.557, datë 22.10.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë; nr.556, datë 30.4.2003 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.689, datë 2.4.2004 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si antikushtetuese.....	1274
Vendim i ERE nr.22, datë 4.5.2005	Për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike, nga shoqëria “Wonder-Power” sh.a.....	1277
Vendim i ERE nr.23, datë 4.5.2005	Për vendosjen e gjobës ndaj shoqërive “Essegei-Shqipëri-Smokthina” sh.p.k. dhe “Hydroelectric Company of Albania” sh.p.k.	1277
	Shpallje kërkesë për shpronësim me objekt shpronësimin e pronarëve, pasuritë pronë private të të cilëve preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Qafë Kashar-Rinas.....	1278
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Ali Cakrri	1282
	Ndreqje gabimi.....	1283

DEKRET
Nr.4529/1, datë 8.4.2005

PËR LEJIM LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Rendit Publik,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Taulant Esad Kurtabegu
2. Ilma Taulant Kurtabegu
3. Lindita Haki Kurtabegu (Puka)
4. Donika Ndue Gjikolaj
5. Tixhei Ismet Gjikolaj
6. Agron Ali Tahiri
7. Rudina Ferit Straub (Çela)
8. Shpresa Stavri Çaçi (Qeleshi)
9. Mirela Ali Zuberovski (Cani)
10. Juljeta Alush Zuberovski
11. Jenifer Alush Zuberovski
12. Eron Alush Zuberovski
13. Rudina Xhaferr Lukaßen (Peza)
14. Kim Vanessa Mario Lukaßen
15. Marsida Gëzim Meçani
16. Saverina Vadim Simahin
17. Edmond Haxhi Disha
18. Matilda Nexhip Seferi (Beçoku)
19. Ilir Kostaq Kotori
20. Ilva Ilir Kotori
21. Vasilika Stathi Kotori (Papingji)
22. Olti Ilir Kotori
23. Etela Ditar Kokona
24. Ermir Farruk Dvorak
25. Haxhi Mehmet Doma
26. Sheila Haxhi Doma
27. Anila Sabri Doma (Hyspeqini)
28. Zaim Irfan Hoxhaj
29. Engjell Agron Merdani
30. Serxhio Agron Merdani
31. Melkior Paulin Zadrime
32. Paolo Melkior Zadrime
33. Vasillaq Gligor Caliqi
34. Marcellino Vasillaq Caliqi
35. Amadea Gjon Stefa
36. Sokol Luan Hajdarmataj
37. Arta Agim Rexhepi (Pashollari)
38. Sara Bajram Rexhepi
39. Arba Bajram Rexhepi
40. Jon Bajram Rexhepi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

VENDIM
Nr.289, datë 15.4.2005

PËR PËRCAKTIMIN E KËRKESAVE DHE TË PROCEDURAVE PËR MIRATIMIN E LEJEVE, TË AUTORIZIMEVE DHE TË KONCESIONEVE PËR PËRDORIMIN E UJIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 6, 7, 12, 18 e 72 të ligjit nr.8093, datë 21.3.1996 “Për rezervat ujore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Deklarimet për përdorim të lirë të ujit nga subjektet fizike të bëhen pranë agjencive të ujit të baseneve ujëmbledhëse (më poshtë agjencia), sipas formularit “A”, të miratuar nga Këshilli Kombëtar i Ujit (më poshtë K KU).

2. Subjektet, juridike dhe fizike, vendase apo të huaja, të paraqesin, pranë sekretariatit teknik të K KU-së (më poshtë sekretariati) ose agjencisë, një kërkesë për marrjen e lejeve, të autorizimeve apo marrjen me koncesion, për përdorimin e ujit, sipas formularëve të miratuar nga K KU-ja.

3. Kërkesat për marrjen e lejeve dhe të autorizimeve për përdorimin e ujit paraqiten në:

a) agjenci, kur veprimtaria do të kryhet brenda kufirit të basenit;
b) sekretariat, kur veprimtaria do të kryhet jashtë kufirit të një baseni të vetëm dhe në rastet kur veprimtaria ka si objekt “lundrueshmërinë” ose “ndërtimin e strukturave ankoruese, portuale”.

4. Lejet dhe autorizimet për përdorimin e ujit, përkatësisht, sipas formularëve “B” e “D”, të miratuara nga K KU-ja, miratohen nga:

a) Këshilli i Basenit Ujëmbledhës (më poshtë KBU) kur veprimtaria do të kryhet brenda kufirit të basenit;

b) K KU-ja, kur veprimtaria do të kryhet jashtë kufirit të një baseni të vetëm.

Në këtë rast duhet marrë më parë mendimi i sekretariatit;

c) K KU-ja, kur veprimtaria ka si objekt “lundrueshmërinë” ose “ndërtimin e strukturave ankoruese, portuale”.

5. Kohëzgjatja e lejeve dhe e autorizimeve të jetë si më poshtë vijon:

a) Lejet jepen për një afat 5-vjeçar, me të drejtë rinovimi çdo vit.

b) Autorizimet jepen për një afat deri në 2 vjet.

Kur studimi del me sukses dhe në kushtet e autorizimit është parashikuar e drejta për kërkesë për leje ose koncesion, i autorizuari duhet ta paraqesë kërkesën brenda 6 muajve nga data e përfundimit të studimit.

6. Subjektet që përdorin ujin (nga pus-shpimet ose burimet natyrore) në veprimtaritë, si në restorante, bare, hotele, pishina, për rritjen e rrasatit të peshkut, në stallat e blegtorisë, pulari, lavazhe, për përpunimin e mermerit, në nyjet e prodhimit të inerteve, si dhe për proceset teknologjike, të përcaktuara në tabelën 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të pajisen me leje nga K KU-ja a KBU-ja, sipas formularit “B”.

7. Kërkesat për koncesion për përdorimin e ujit, në funksion të prurjes së kërkuar, të paraqiten pranë sekretariatit ose agjencisë, sipas tabelave nr.1, nr.2 dhe nr.4, që i bashkëlidhen këtij vendimi (kolonat 10 dhe 11).

8. Ndërmarrjet ose sha-të e ujësjellës-kanalizimeve, te zonat që ato ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, pasi të kenë plotësuar nevojat e popullsisë, lidhin kontratë koncesioni me subjektet, të cilëve u nevojitet përdorimi i ujit nga rrjeti i ujësjellësit. Kjo kontratë bëhet e vlefshme pas miratimit nga KBU-ja përkatëse.

9. Dhënia e koncesioneve për përdorimin e ujit, me përjashtim të rasteve të pikave 17 e 18 të

këtij vendimi, bëhet me miratimin e KKU-së a KBU-së, sipas procedurave të mëposhtme:

a) Në rastin e një propozimi të kërkuar, që nënkupton se KKU-ja a KBU-ja ka vendosur të japë përdorimin e ujit me koncesion, në përputhje me planin kombëtar të rezervave ujore, me planet e rezervave ujore të baseneve ujëmbledhëse apo me studimet e tjera specifike, subjektet e interesuara, pas shpalljes së konkursit, u nënshtrohen procedurave të konkurrimit.

b) Në rastin e një propozimi të pakërkuar, që nënkupton se janë subjektet, që kanë paraqitur kërkesën për përdorimin e ujit me koncesion, dhe KKU-ja ose KBU-ja, pasi merr mendimin e sekretariatit a të agjencisë për parametrat kryesorë të burimit ujor dhe impaktet e përdorimit të tij, gjykon dhe vendos nëse subjektet do t'u nënshtrohen procedurave të konkurrimit.

Sekretariati ose agjencia mund të kërkojë oponencë për propozimet e përmendura në shkronjat "a" e "b", nga organet a institutet e specializuara, financiare dhe teknike, si dhe nga këshilli konsultativ teknik i ngritur pranë tij/saj.

Në rast se fillohet procedura e konkurrimit dhe nuk paraqitet asnjë subjekt tjetër i interesuar, vazhdohet procedura me subjektin që ka paraqitur ofertën.

Koncesionet për përdorimin e ujit jepen për një afat deri në 30 vjet.

10. Për kërkesat e përcaktuara në pikat 3 shkronja "b" dhe 7 të këtij vendimi, që i drejtohen sekretariatit, para se të shqyrtohen nga KKU-ja, të merret mendimi i KBU-së përkatëse.

11. Përgatitja e dokumentacionit të konkursit dhe procedurat e konkurrimit kryhen nga sekretariati ose agjencia.

12. Format e konkursit janë:

a) Konkurs i hapur, që përdoret për prurjet sipas rreshtave 1-3 të tabelës nr.1 dhe 1-2 të tabelës nr.2;

b) Konkurs ndërkombëtar, që përdoret për prurjet sipas rreshtave 4-5 të tabelës nr.1 rreshti 3 i tabelës nr.2 dhe rreshtave 1-2 të tabelës nr.4, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

13. Mënyra e përgatitjes së konkursit është si më poshtë vijon:

13.1 Për një pjesëmarrje sa më të gjerë të subjekteve të interesuara dhe për të tërhequr një numër sa më të madh ofertash, shpallja e konkursit të bëhet:

a) për konkursin e hapur, në dy gazeta kombëtare;

b) për konkursin ndërkombëtar, në një gazetë të njohur ndërkombëtare, në një gazetë kombëtare dhe nëpërmjet medias elektronike.

13.2 Subjektet të marrin, pranë sekretariatit ose agjencisë, dokumentacionin standard, që duhet të plotësojnë për të marrë pjesë në konkurs, ku u jepen sqarimet e nevojshme për plotësimin dhe afatet e dorëzimit të tij. Dokumentacioni standard i konkursit miratohet nga KKU-ja dhe përmban:

a) Ftesën për ofertë, me këto elemente:

i) Procedurën e konkursit;

ii) Emrin e burimit ujor dhe tipin e tij;

iii) Vendndodhjen e burimit;

iv) Karakteristikat kryesore të burimit (prurja, kimizimi etj.);

v) Sasinë e ujit që jepet për përdorim;

vi) Qëllimet e përdorimit (pa kufizuar të drejtën e subjekteve për propozime të tjera);

vii) Ditën dhe orën e hapjes së ofertave;

viii) Afatin dhe çmimin e tërheqjes së dokumenteve të konkursit pranë sekretariatit ose agjencisë përkatëse;

ix) Adresën e sekretariatit ose agjencisë;

b) Udhëzimin për pjesëmarrësit në konkurs.

Perioda ndërmjet afatit të tërheqjes së dokumentacionit të konkursit dhe të dorëzimit të propozimeve të jetë:

- jo më shumë se 30 ditë për konkursin e hapur;

- jo më shumë se 45 ditë për konkursin ndërkombëtar.

c) Kontratën tip, të miratuar nga KKU-ja.

ç) Kontratën tip të koncesionit, të miratuar nga KKU-ja.

d) Kërkesat për kualifikim (dokumentacioni juridik), të parashikuara në formularin "C", të miratuar nga KKU-ja.

dh) Dokumentacionin teknik dhe atë ekonomiko-financiar, të parashikuar në formularin "C", të miratuar nga KKU-ja.

e) Shtojcën me shpjegimet e nevojshme për pjesët përbërëse të formularit “C” dhe për mënyrën e plotësimit të tij etj.

ë) Termat specifike për burimin ujq, kur është e nevojshme e sipas rastit.

f) Tabelën përkatëse të tarifave të përdorimit të ujq, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

13.3 Dokumentacioni dorëzohet në 2 zarfe të mbyllura, të veçanta, ku në njërën, zarfi nr.1, futet formulari i aplikimit e dokumentacioni juridik, ndërsa në tjetrin, zarfi nr.2, dokumentacioni teknik dhe ai ekonomiko-financiar. Dokumentacioni i kërkuar të dorëzohet në origjinal dhe/ose i noterizuar.

Përveç dokumentacionit të mësipërm, sekretariati ose agjencia, kur e sheh të nevojshme, mund t’u kërkojë pjesëmarrësve në konkurs edhe dokumente a të dhëna të tjera.

14. Mënyra e zhvillimit të konkursit

14.1 Hapja e ofertave do të bëhet nga një komision, me minimumi 5 veta, i përbërë nga punonjësit e sekretariatit dhe specialistët e caktuar nga zëvendëskryetari i KKU-së, për sekretariatit, ose nga punonjësit e agjencisë dhe nga specialistët (njëri prej të cilëve duhet të jetë jurist), të caktuar nga kryetari i KBU-së, për agjencinë.

Në ditën dhe orën e caktuar, sekretariati ose agjencia, në prani të të gjithë përfaqësuesve të subjekteve që kanë sjellë propozime, shqyrton zarfin nr.1.

Nëse sekretariati ose agjencia vëren mangësi ose parregullsi në dokumentacionin e paraqitur, subjektet përkatëse skualifikohen nga konkursi.

Në rastet kur sekretariati ose agjencia gjykon të domosdoshëm ndonjë ndryshim a plotësim në dokumentacion, u kërkon subjekteve pjesëmarrëse që, brenda një periudhe të caktuar (jo më vonë se një e treta e afatit të caktuar për përgatitjen e dokumentacionit të propozimit), të bëjnë ndryshimet ose plotësimet e nevojshme.

14.2 Kriteret e vlerësimit të propozimeve

Sekretariati ose agjencia, pasi shqyrton zarfin nr.2, bën vlerësimin me pikë të subjekteve, si më poshtë vijon:

Maksimumi i mundshëm,	në pikë
Vlerësimi i dokumentacionit teknik	25
- Projekti i përdorimit të ujq	10
- Sasia më e vogël e përdorimit të ujq (1/sek)	10
- Cilësia e pajisjeve që do të përdoren	5
Vlerësimi i dokumentacionit ekonomiko-financiar	75
- Tarifa më e lartë e pagesës, e propozuar nga konkurruesi, për njësinë e ujq (ku tarifa më e ulët përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave)	28
- Periudha më e shkurtër e koncesionit	15
- Synimet e biznesit (rritja e gamës së prodhimeve, shtimi i tregjeve etj.)	
- Periudha më e shpejtë për vënien në shfrytëzim të burimit ujq dhe frytshmëria e tij	10
- Përvoja në fushën përkatëse të përdorimit të ujq	5
- Mundësia financiare për investimin, besueshmëria e huasë	3
- Niveli i plotësimit të kërkesave për ofertë	2
- Besueshmëria e ofertës (mundësia reale për realizimin e kësaj oferte)	7
Shuma	100

Që subjektet të kualifikohen duhet të plotësojnë 75 pikë nga 100 të mundshme (përfshihen nga ky kusht koncesionet për prodhim hidroenergjie dhe për vaditje, deri në miratimin e tarifave përkatëse nga Këshilli i Ministrave).

Procedura e mësipërme dhe vlerësimi në pikë zhvillohet edhe sikur të jetë një subjekt i vetëm propozues.

Nëse dy apo më shumë subjekte vlerësohen me pikë të barabarta, përparësi ka subjekti që ka kryer një studim të burimit ujq, në bazë të një autorizimi të dhënë nga KKU-ja ose KBU-ja. Në rastet e tjera, ka përparësi subjekti që ofron tarifën me të lartë të pagesës për përdorimin e ujq.

14.3 Shpallja e listës së vlerësimit.

Sekretariati ose agjencia, brenda 15 ditëve nga data e hapjes së ofertave, shqyrton

dokumentacionin teknik dhe ekonomiko-financiar, si dhe harton listën e vlerësimit të tyre sipas renditjes së pikëve. Kjo listë shpallet në vende të caktuara në Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit ose në agjenci.

Subjekteve pjesëmarrëse në konkurs, brenda 30 ditëve nga dita e shpalljes së listës së vlerësimit, u lind e drejta të ankohen pranë ministrit përkatës kur konkursi zhvillohet nga sekretariati, ose pranë drejtuesit të sekretariatit kur konkursi zhvillohet nga agjencia. Ndaj vendimeve të ministrit ose të drejtuesit të sekretariatit mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 30 ditëve nga marrja dijeni për vendimin.

14.4 Shpallja e fituesit

Sekretariati ose agjencia, pasi ka bërë klasifikimin e subjekteve të kualifikuara dhe pas plotësimit të afatit të ankimit të subjekteve, brenda 5 ditëve paraqet materialin përkatës për miratim në mbledhjen e radhës së KKU-së a KBU-së, të cilat vendosin shpalljen e fituesit.

Nëse KKU-ja ose KBU-ja vëren parregullsi në procedurat e vlerësimit, ia kthen për rishqyrtim materialin përkatës sekretariatit ose agjencisë, të cilët, brenda 10 ditëve, duhet ta ridërgojnë për miratim në KKU ose KBU.

Procesverbali i mbledhjes, së bashku me dokumentacionin e konkursit ruhen nga sekretariati ose agjencia në një dosje, me emërtimin e konkursit, në përputhje me ligjin “Për arkivat”. Këto dokumente u vihen në dispozicion, sa herë që kërkohen, organeve të autorizuar për kontroll apo verifikim.

Sekretariati dhe agjencia, brenda 10 ditëve nga marrja e vendimit të KKU-së a KBU-së për shpalljen e fituesit, njofton subjektin fitues për nënshkrimin e kontratës me kusht.

Subjekti fitues, brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit për shpalljen fitues, duhet të paraqesë një garanci bankare, ku të ketë të ngurtësuar 2 për qind të vlerës së investimit të parashikuar.

15. Kontrata me kusht

Kontrata me kusht është akt juridik, që nënshkruhet nga drejtuesi i sekretariatit ose agjencisë dhe subjektit fitues. Kontrata duhet të përmbajë këto kushte:

a) Objektin, pranimin e lidhjes së kontratës së koncesionit, në përputhje me ofertën e paraqitur dhe kërkesat e parashikuara në dokumentacionin e konkursit;

b) Afatin tremujor të vlefshmërisë, deri në lidhjen e kontratës së koncesionit;

c) Zotimin e subjektit që, brenda këtij afati, të negociojë dhe të përfundojë kontratën e koncesionit, të cilën duhet ta dorëzojë së bashku me:

- vërtetimin e pronësisë (nga hipoteka a kadastra) ose kontratën apo aktmarrëveshjen për blerjen a marrjen me qira të truallit ku do të investohet;

- lejen mjedisore nga Ministria e Mjedisit;

- dokumentin e kualifikimit profesional.

ç) Plotësimin e detyrimeve nga subjekti fitues sipas kësaj kontrate me kusht, brenda 3 muajve. Në të kundërt, nëse për faj të tij nuk arrihet lidhja e kontratës së koncesionit, e pranueshme për të dyja palët, subjekti humbet të drejtën e marrjes me koncesion dhe i mbahet garancia bankare për sigurimin e lidhjes së kontratës. Në këtë rast, njoftohet të paraqitet për negociim subjekti i kualifikuar i dyti dhe, nëse ai pranon, përsëritet procedura, duke filluar nga nënshkrimi i kontratës me kusht, e kështu me radhë për subjektet e tjera.

Sekretariati ose agjencia, gjatë periudhës së negociimit të kontratës, së koncesionit mund të kryejë kontrolle dhe sondazhe për besueshmërinë e të dhënave të paraqitura nga fituesi i tenderit.

16. Miratimi dhe nënshkrimi i kontratës së koncesionit

Kur pas negociimeve, ndërmjet sekretariatit ose agjencisë dhe subjektit, arrihet në përfundim se kontrata e koncesionit, e paraqitur nga subjekti është e pranueshme për të dyja palët, ajo nënshkruhet nga drejtuesi i sekretariatit a i agjencisë dhe nga përfaqësuesi ligjor i subjektit.

Kontrata paraqitet nga sekretariati ose agjencia në mbledhjen e radhës së KKU-së ose KBU-së, ku merret vendimi për miratimin ose jo të saj. Në rastin e mosmiratimit, për ndryshime apo plotësime, kontrata i rikthehet sekretariatit ose agjencisë, të cilat pas korrigjimeve, brenda një afati të përcaktuar në mbledhje, e paraqesin përsëri për miratim në KKU ose KBU.

Për rastet kur miratimi i kontratës është e drejtë e Këshillit të Ministrave, ajo, pas miratimit nga KKU-ja, dërgohet për miratim në Këshillin e Ministrave.

17. Për kërkesat e paraqitura për përdorimin e ujit për:

a) furnizimin me ujë të pijshëm të popullsisë nga ndërmarrjet ose shoqëritë anonime (sha-të) të ujësjellës-kanalizimeve;

b) ujitjen nga federatat dhe shoqatat e përdoruesve të ujit;

lidhet kontratë koncesionare, ndërmjet sekretariatit a agjencisë dhe:

- përfaqësuesit të pushtetit vendor, që zotëron asetet e ndërmarrjeve ose shoqërive anonime (sha-të) të ujësjellës-kanalizimeve, për rastet e shkronjës “a” të kësaj pike;

- përfaqësuesve të federatave dhe shoqatave të përdoruesve të ujit, për rastet e shkronjës “b” të kësaj pike;

Kontratat e koncesionit, për rastet e përmendura në shkronjat “a” e “b” të kësaj pike, lidhen sipas modeleve tip, të miratuara nga KKU-ja.

18. Për kërkesat e paraqitura për përdorimin e ujit, për prodhim hidroenergjie, lidhet kontratë koncesionare ndërmjet ministrive të fushave përkatëse dhe përfaqësuesve të subjekteve që kanë aplikuar për përdorim të ujit. Kontrata e koncesionit për këtë rast negociohet nga palët para miratimit të dhënies së koncesionit nga Këshilli i Ministrave.

19. Organet përgjegjëse për miratimin e kontratës së koncesionit përcaktohen në tabelat nr.1, nr.2 dhe nr.4, që i bashkëlidhen këtij vendimi (kolonat 6, 7, 8 dhe 9).

20. Afatet, brenda të cilave subjekti që ka fituar të drejtën e përdorimit të ujit duhet të fillojë veprimtarinë, janë:

- për autorizimet 3 muaj;

- për lejet 2 muaj;

- për koncesionet afati i shënuar në kontratë.

Pas këtij afati, për lejet dhe autorizimet subjekti humbet të drejtën e përdorimit të ujit, kurse për koncesionet, e drejta për përdorim të ujit i jepet, pas plotësimit të të gjitha procedurave të përcaktuara në këtë vendim, subjektit të klasifikuar i dyti në listën e vlerësimit të konkursit.

21. Pranë sekretariatit dhe agjencisë, bazuar në regjimet e përdorimit të ujit, krijohen regjistra të veçantë për:

- deklarinimet për përdorim të lirë të ujit;

- autorizimet për kërkime, studime dhe zbulime në fushën e ujit, me përjashtim të kërkimit shkencor në fushën e peshkimit dhe akuakulturës;

- lejet për përdorim uji;

- koncesionet për përdorim uji.

22. Të gjitha institucionet që kanë lidhje me fushën e përdorimit të ujit, të mos japin leje të reja apo të rinovojnë lejet e lëshuara, nëse subjektet kërkuese nuk janë të pajisura me lejen, autorizimin apo kontratën e koncesionit përkatës për përdorimin e ujit nga KKU-ja dhe KBU-ja.

23. Vendimi nr.63, datë 26.1.2001 i Këshillit të Ministrave “Për procedurat e kërkimit, të shqyrtimit dhe të dhënies së autorizimeve, të lejeve dhe koncesioneve për përdorim të rezervave ujore” dhe udhëzimi nr.2, datë 26.1.2001 i Këshillit të Ministrave, shfuqizohen.

24. Ngarkohet Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

KOMPETENCAT E AUTORITETEVE TË UJIT PËR
MIRATIM LEJESH DHE KONCESIONESH
(Në funksion të qëllimit të përdorimit dhe të sasisë së ujit)

Tabelë nr. 1

Rezervë ujore për ujë të pijshëm dhe të konfeksionuar

Nr.	Qëllimi i përdorimit	Njësia	Sasia		Autoriteti i ujit që miraton			Ratifikon Kuvendi	Organi ku aplikohet	
			>	< =	KBU	KKU	Këshilli i Ministrave		Agjencia e Ujit	Sekretariati Teknik i KBU
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	Për pirje	l/sek	0	100						
2	Për konfeksionim	"	0	5						
3	Për pirje	"	100	2000						
4	Për konfeksionim	"	5	300						
5	Për pirje	"	> 2000							

Tabelë nr. 2

Rezervë ujore për ujitje

Nr.	Qëllimi i përdorimit	Njësia	Sasia		Autoriteti i ujit që miraton			Ratifikon Kuvendi	Organi ku aplikohet	
			>	< =	KBU	KKU	Këshilli i Ministrave		Agjencia e Ujit	Sekretariati Teknik i KBU
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	Ujë për ujitje	Mln/m ³ në vit	< = 5							
2			5	20						
3			> 20							

Tabelë nr. 3

Rezervë ujore për proces teknologjik

Nr.	Qëllimi i përdorimit	Njësia	Sasia		Autoriteti i ujit që miraton			Ratifikon Kuvendi	Organi ku aplikohet	
			>	< =	KBU	KKU	Këshilli i Ministrave		Agjencia e Ujit	Sekretariati Teknik i KKKU
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	Ujë për proces teknologjik	l/sek	0	5						
2			5	100						
3				> 100						

Tabelë nr. 4

Rezervë ujore për eksport

Nr.	Qëllimi i përdorimit	Njësia	Sasia		Autoriteti i ujit që miraton			Ratifikon Kuvendi	Organi ku aplikohet	
			>	< =	KBU	KKU	Këshilli i Ministrave		Agjencia e Ujit	Sekretariati Teknik i KKKU
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	Ujë për eksport	l/sek	0	500						
2				> 500						

VENDIM
Nr.291, datë 6.5.2005

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.230, DATË 22.7.1991 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN E KOMISIONEVE TË TOKAVE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7 të ligjit nr.7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.230, datë 22.7.1991 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në kapitullin II “Komisioni i tokës në qark”, të bëhen shtesa dhe ndryshimi si më poshtë vijon:

a) Në fund të pikës 4 shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Shqyrton konfliktet për tokën bujqësore ndërmjet palëve, kur për to është vendosur

rishqyrtimi në rrugë administrative, me vendime të formës së prerë të organeve gjyqësore. Në përfundim të këtij shqyrtimi, kërkon nga komisionet e komunave dhe/ose bashkive marrjen e vendimeve të bazuara, ligjore.”.

b) Në fund të paragrafit të parë të pikës 8, hiqen fjalët “..., i cili drejtohet nga kryetari i fshatit.”.

2. Në kapitullin II/a “Komisioni i tokës në komunë”, të bëhen këto shtesa:

a) Pas shkronjës “c” shtohet shkronja “c/1”, me këtë përmbajtje:

“c/1) Shqyrton mosmarrëveshjet dhe konfliktet ndërmjet individëve brenda fshatit, që kanë lindur në vijimësi të procesit të ndarjes së tokës dhe që deri në kohën e shqyrtimit nuk kanë marrë zgjidhje ligjore. Në këto raste, komisioni, pasi shqyrton dokumentacionin ekzistues të palëve në konflikt, përputhshmërinë e tij me dokumentacionin përkatës, që ndodhet pranë komunës, si dhe me dokumentet që zotëron komisioni i fshatit përkatës, merr vendim për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

Vendimi i dërgohet për shqyrtim dhe miratim komisionit të tokës në qark. Pas shqyrtimit dhe miratimit të tij në komisionin e qarkut, komisioni i tokës në komunë merr vendimin përfundimtar. Ky vendim është i formës së prerë.

Objekti i vendimit të formës së prerë nuk mund të jetë sipërfaqja e tokës bujqësore, objekt i ligjit nr.8312, datë 26.3.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”.”.

b) Pas paragrafit të parë të shkronjës e/1, shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Fshatra dhe tokë bujqësore në juridiksion të bashkisë janë të gjitha ato qendra të banuara dhe sipërfaqet përkatëse, në përbërje të ish-NB-ve, të ndodhura në periferi të qyteteve dhe që administrativisht kanë qenë në varësi të ish-komiteteve ekzekutive të qyteteve përkatëse deri në ndryshimin e strukturës së qeverisjes vendore, në korrik të vitit 1992.”.

3. Në kapitullin III “Komisioni i tokës në fshat”, të bëhen këto ndryshime:

a) Paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë vijon:

“Komisioni i tokës në fshat miratohet nga komisioni i tokës i qarkut dhe ka në përbërje kryetarin e komisionit, i cili është kryetari i fshatit, dhe 2 ose 4 anëtarë të komisionit, specialistë, si agronomë e topografë.

Komisioni i tokës në fshat ka për objekt veprimtarie ndarjen e tokës vetëm për sipërfaqet që janë përcaktuar në ligjin nr.8312, datë 26.3.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”. Në këtë rast, vendimet e komisionit janë të formës së prerë.”.

b) Pika 1 ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. Merr në shqyrtim kërkesat, për tokë bujqësore, që janë paraqitur për t’u trajtuar, nga individë apo familje bujqësore, banues në fshatin ku ndodhet toka e destinuar për ndarje, sipas objektit të ligjit nr.8312, datë 26.3.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”.”.

c) Pika 2 ndryshohet si më poshtë vijon:

“2. Verifikon pajtueshmërinë e kërkesave të paraqitura me kriteret e përcaktuara në vendimin nr.255, datë 2.8.1991 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret e ndarjes së tokës bujqësore”.”.

ç) Pika 3 ndryshohet si më poshtë vijon:

“3. Përcakton madhësinë e tokës bujqësore dhe vendin ku do t’u jepet toka familjeve dhe individëve, që kanë paraqitur kërkesë dhe, paraprakisht, është vlerësuar se kërkesa e tyre është në përputhje me kriteret e vendimit nr.255, datë 2.8.1991 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret e ndarjes së tokës bujqësore”. Ndarja e tokës bëhet duke llogaritur numrin e frymëve me normën mesatare të subjektit, ku është ndarë toka.”.

d) Në pikën 6 fjalët “Zyra e kadastrës” zëvendësohen me “Seksioni i Administrimit dhe i Mbrotjtjes së Tokës (SAMT)”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.292,datë 6.5.2005

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.315, DATË 23.6.2000 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E INSTITUTIT TË

TRAJNIMIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE TRAJNIMIN E NËPUNËSIT CIVIL”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 29 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Shtetit për Koordinimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.315, datë 23.6.2000 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime e shtesa:

1. Në shkronjat “c” pika 4, dhe “dh”, “f” e “h”, pika 7, fjalët “...trajnerët e përhershëm...” zëvendësohen me “...menaxherët e trajnimit...”.

2. Në fund të pikës 5 shtohen fjalët “..., një përfaqësues i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe një përfaqësues i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.”.

3. Pas pikës 5 shtohet pika 5/a, me këtë përmbajtje:

“5/a. Ministrinë e linjës dhe institucionet e tjera të administratës qendrore përcaktojnë deri në muajin qershor të çdo viti, nevojat për trajnime për nëpunësit e tyre gjatë vitit pasardhës dhe ia paraqesin për veprim Institutit të Trajnimit të Administratës Publike.”.

4. Paragrafi i parë i pikës 8, ndryshohet si më poshtë vijon:

“Veprimtaria trajnuese zhvillohet nën drejtimin e menaxherëve të trajnimit, të cilët organizohen sipas veprimtarisë në qendrën e trajnimit të përgjithshëm dhe në qendrën e trajnimit fiskal të këtij instituti. Menaxherët e trajnimit kanë këto detyra:”.

5. Në pikën 10 fjalët “...e përbërë prej tre personash...” shfuqizohen.

6. Shkronja “c” e pikës 11, ndryshohet si më poshtë vijon:

“c) të ardhurat që jepen nga ministrinë e ndryshme apo institucionet e tjera, për nevojat e trajnimit të nëpunësve të tyre.”.

7. Në pikën 19 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në fjalinë e parë të paragrafit të parë, fjalët “...pagën bazë...” zëvendësohen me “...pagën e plotë, përjashtuar shtesat për vështirësi dhe kushte pune...”.

b) Në shkronjën “a”, fjalët “...e pagës bazë...” zëvendësohen me “...pagën e plotë, përjashtuar shtesat për vështirësi dhe kushte pune...”.

c) Në shkronjën “b” fjalët “...e pagës bazë...” zëvendësohen me “...pagën e plotë, përjashtuar shtesat për vështirësi dhe kushte pune...”.

8. Në pikën 20 fjalët “...e pagës bazë...” zëvendësohen me “...pagën e plotë, përjashtuar shtesat për vështirësi dhe kushte pune...”.

9. Tre punonjësit, që kanë kaluar nga organika e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve në organikën e Këshillit të Ministrave, me vendimin nr.209, datë 7.4.2005 të Këshillit të Ministrave “Për një ndryshim në vendimin nr.124, datë 2.3.2005 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e numrit të punonjësve buxhetorë të ministrive dhe institucioneve qendrore, për vitin 2005””, të jenë pjesë e organikës së Institutit të Trajnimit të Administratës Publike.

10. Në buxhetin e vitit 2005, miratuar për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, në zërin “Paga dhe sigurime” pakësohet shuma 2 313 000 (dy milionë e treqind e trembëdhjetë mijë) lekë, e cila shtohet në buxhetin e po këtij viti, miratuar për Këshillin e Ministrave, për Institutin e Trajnimeve të Administratës Publike.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Fatos Nano**

**VENDIM
Nr.298, datë 6.5.2005**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.726, DATË 21.12.2000 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “ PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË INSTITUCIONEVE
BUXHETORE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9339, datë 21.12.2004 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005”, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Koordinimin dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 19 ndryshohet si më poshtë vijon:

“19. Për punonjësit efektivë pedagogjiko-shkencorë e kërkimorë në universitete dhe shkolla të tjera të larta dhe punonjësit efektivë kërkimorë e shkencorë, në institutet kërkimore-shkencore, në sistemin e Akademisë së Shkencave, paga bazë mujore të jetë si më poshtë vijon:

- Profesor A 8;
- Profesor i asociuar A11;
- Lektor B 2.

Kur këta punonjës caktohen në funksione drejtuese, përveç pagës përkatëse, të marrin edhe shtesën në përqindje mbi këtë pagë, si më poshtë vijon:

- Rektor i universitetit të kategorisë I 25%;
- Zëvendësrektor i universitetit të kategorisë I
- Rektor i universitetit të kategorisë II 20%;
- Drejtor instituti
- Sekretar shkencor i seksionit në Akademinë e Shkencave
- Zëvendësrektor i universitetit të kategorisë së II 17%;
- Dekan 15%;
- Zëvendësdrejtor instituti
- Drejtor në qendrën kërkimore-shkencore
- Zëvendësdekan 13%;
- Përgjegjës departamenti 12%;
- Përgjegjës i qendrës kërkimore
- Kryetar seksioni në Akademinë e Shkencave 10%;
- Përgjegjës seksioni
- Përgjegjës sektori 8%.”.

2. Pika 19/1 ndryshohet si më poshtë vijon:

“19/1. Për punonjësit efektivë, kërkimorë e shkencorë, në institutet kërkimore-shkencore, në varësi të ministrive, paga bazë mujore të jetë:

- Profesor B2;
- Profesor i asociuar B3;
- Punonjës kërkimor B5.

Kur këta punonjës caktohen në funksione drejtuese, përveç pagës përkatëse, të marrin edhe shtesën në përqindje mbi këtë pagë, si më poshtë vijon:

- Drejtor instituti 17%;
- Zëvendësdrejtor instituti
- Drejtor në qendrën kërkimore-shkencore 13%;
- Përgjegjës departamenti 12%;
- Përgjegjës i qendrës kërkimore
- Përgjegjës shërbimi 10%;
- Përgjegjës seksioni
- Përgjegjës klinike
- Përgjegjës sektori 8%.”.

3. Pas pikës 19/1, shtohet pika 19/2, me këtë përmbajtje:

“19/2. Punonjësve, që nuk janë efektivë të shkollave të larta ose të instituteve kërkimore-shkencore, por janë bashkëpunëtorë në veprimtaritë e këtyre shkollave ose instituteve, si dhe punonjësve efektivë të shkollave të larta, që nuk janë punonjës pedagogjikë (janë nëpunës), t’u jepet

shpërblim mujor si më poshtë vijon:

- Profesor 5600 lekë;
- Profesor i asociuar 4900 lekë;
- Për gradën shkencore “Doktor i shkencave” 4200 lekë.”.

4. Në lidhjen II-A, kreu II, “Shtesa të tjera”, pika 18 shfuqizohet.

5. Në lidhjen I “Renditja e funksioneve sipas klasifikimit”, të bëhen këto shtesa e ndryshime:

a) Në klasifikimin “A8” shtohet emërtesa “Profesor në universitete dhe shkolla të tjera të larta, si dhe në institutet kërkimore-shkencore të sistemit të Akademisë së Shkencave”.

b) Në klasifikimin “A11” shtohet emërtesa “Profesor i asociuar në universitete dhe shkolla të tjera të larta, si dhe në institutet kërkimore shkencore të sistemit të Akademisë së Shkencave”.

c) Në klasifikimin “B2” bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

i) Shtohen emërtesat “Lektor” dhe “Punonjës kërkimor në institutet kërkimore-shkencore të sistemit të Akademisë së Shkencave”.

ii) Emërtesa “Profesor, drejtues kërkimesh” zëvendësohet me “Profesor në institutet kërkimore-shkencore, në varësi të ministrive”.

ç) Në klasifikimin “B3” bëhen shtesa dhe ndryshimi si më poshtë vijon:

i) Pas emërtesës “Pedagog” shtohet emërtesa “Kërkues në institutet kërkimore-shkencore të sistemit të Akademisë së Shkencave”.

ii) Emërtesa “Profesor i asociuar, mjeshtër kërkimesh” zëvendësohet me “Profesor i asociuar në institutet kërkimore-shkencore, në varësi të ministrive”.

d) Në klasifikimin “B4”, pas emërtesës “Asistent në shkollat e larta” shtohet emërtesa “Asistent në institutet kërkimore-shkencore të sistemit të Akademisë së Shkencave”.

dh) Në klasifikimin “B5” emërtesa “Kërkues me gradë shkencore” zëvendësohet me “Punonjës kërkimor në institutet kërkimore shkencore, në varësi të ministrive”.

e) Në klasifikimin “C2” emërtesa “Kërkues” zëvendësohet me “Kërkues në institutet kërkimore-shkencore, në varësi të ministrive”.

ë) Në klasifikimin “C3” emërtesa “Asistent” zëvendësohet me “Asistent në institutet kërkimore-shkencore, në varësi të ministrive”.

6. Në lidhjen II-5 “Niveli i pagave për punonjësit e ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore”, në pjesën e dytë, në numrin rendor 19, fjalët “...të klasifikimit A12”, shfuqizohen.

7. Në lidhjen II-8 “Niveli i pagave për punonjësit e Akademisë së Shkencave”, në pjesën e parë bëhen këto ndryshime:

a) Emërtesa “Drejtues kërkimesh” zëvendësohet me “Profesor”, me pagë sipas klasifikimit “A8”;

b) Emërtesa “Mjeshtër kërkimesh” zëvendësohet me “Profesor i asociuar”, me pagë sipas klasifikimit “A11”;

c) Emërtesa “Kërkues me gradë shkencore”, zëvendësohet me “Punonjës kërkimor”, me pagë sipas klasifikimit “B2”;

ç) Paga për emërtesën “Kërkues” të jetë sipas klasifikimit “B3”.

8. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondi rezervë i vitit 2005, për rritjen e pagave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet, nga data 1 qershor 2005.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.299, datë 6.5.2005

**PËR FILLIMIN E PROCEDURËS SË NDËRTIMIT ME KONCESION, TË FORMËS “BOT”,
PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALIT TË SKAVICËS, SIPAS PROPOZIMIT TË
PAKËRKUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, 5 e 7 të ligjit nr.7993, datë 26.7.1995 “Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës dhe të Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës së ndërtimit me koncesion, të formës “BOT” (ndërtim-shfrytëzim-transferim), për ndërtimin e hidrocentralit të Skavicës, mbi lumin Drini i Zi, si propozim i pakërkuar, sipas projektit të grupit italian “TGK”.

2. Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës, Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit të jenë Organi Shtetëror i Autorizuar (OSHA) për negocimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes së koncesionit.

3. Ngarkohen Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës, Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

VENDIM

Nr.303, datë 6.5.2005

**PËR PËRCAKTIMIN E SHËRBIMIT TË GJENDJES CIVILE SI SHËRBIM
QË JEPET ME KONCESION**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 11 të nenit 3 të ligjit nr.7973, datë 26.7.1995 “Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e shërbimit të gjendjes civile, si shërbim që jepet me koncesion.

2. Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit dhe Ministria e Ekonomisë të jenë Organi Shtetëror i Autorizuar (OSHA), për realizimin e procedurave përkatëse, për dhënien me koncesion të këtij shërbimi, në përputhje me ligjin nr.7973, datë 26.7.1995, të ndryshuar.

3. Ngarkohen Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit dhe Ministria e Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

VENDIM

Nr.9, datë 9.5.2005

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergj Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Vjollca Meçaj	Anëtare e “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “

me sekretare Arbenka Lalica, në datat 31.1.2005 dhe 14.2.2005, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.32/12 Akti që i përket:

KËRKUES: SKËNDER LUZATI, përfaqësuar nga avokat Avni Shehu, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: ENVER E QEMAL HOXHOLLI, përfaqësuar nga avokat Dashamir Kore, me prokurë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetuese i vendimeve nr.2352, datë 26.5.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr.663, datë 26.5.2003 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.1286, datë 17.6.2004 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 41, 42 e 131/f të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë.

Kërkuesi ka parashtruar se gjykatat kanë zhvilluar një proces të parregullt që, sipas tij, ka konsistuar:

- Gjykimi i çështjes në gjykatën e rrethit është bërë nga një gjyqtar i vetëm, ndërkohë që duhej të bëhej nga një trup gjykues me tre gjyqtarë, sepse nuk është përcaktuar drejt vlera e padisë, pasi vlera e truallit të kërkuar është mbi 10 milionë lekë.

- Gjykata e rrethit ka pranuar e thirrur ekspertë jo kompetentë që janë topografë e jo ekspertë për vlerësimin e pasurisë së paluajtshme.

- Gjykata e rrethit dhe Gjykata e Lartë, nuk kanë vlerësuar si duhet provat që janë administruar. Gjykata e Lartë ka vepruar në kundërshtim me nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile dhe nenin 141 të Kushtetutës, sepse ka bërë një vlerësim të ndryshëm të provave të administruara dhe e ka ndryshuar vendimin e gjykatës së apelit për këtë shkak.

- Gjykata e Lartë ka gabuar, sepse e ka gjykuar çështjen në fakt ndryshe nga sa lejohet sipas nenit 485 të Kodit të Procedurës Civile.

Përfaqësuesi i subjekteve të interesuara ka parashtruar:

- Gjykata e Lartë ka prishur vendimin nr.663, datë 26.5.2003 të gjykatës së apelit jo për shkaqet që parashtron kërkuesi, por për shkak se ajo ka vepruar në kundërshtim me ligjin.

- Pretendimet e parashtruara se përcaktimi i vlerës së padisë dhe i gjykatës kompetente janë bërë në kundërshtim me ligjin, nuk është parashtruar para gjykatave me juridiksion gjyqësor, prandaj për atë ai nuk mund t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fehmi Abdiu, përfaqësuesit e kërkuesit, të subjekteve të interesuara, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.2352, datë 3.6.2002, ka vendosur rrëzimin e padisë së kërkuesit si të pabazuar në ligj dhe në prova.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.663, datë 26.5.2003, ka vendosur ndryshimin e vendimit dhe pranimin e padisë.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.1288, datë 17.6.2004, ka prishur vendimin e

Gjykatës së Apelit Tiranë dhe ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Gjatë shqyrtimit të kërkesës së paraqitur nga kërkuesi, Gjykata Kushtetuese konstaton se ai ka parashtruar pretendime të natyrave të ndryshme, prandaj ajo çmon se ato duhen analizuar veç e veç, duke filluar me atë që ka të bëjë me gjykatën kompetente, e të lidhur ngushtë me të, edhe pretendimin e parashtruar para kësaj Gjykate në lidhje me përcaktimin e vlerës së padisë.

Sipas nenit 131/f të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shterur të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave.

Lidhur me sa sipër, Gjykata Kushtetuese konfirmon edhe një herë qëndrimin e saj të shprehur në vendimin nr.10, datë 2.4.2003 se, sipas kuptimit të nenit 131/f të Kushtetutës, “Mbrojtja kushtetuese ka një funksion përfundimtar që do të thotë se mund të aplikohet vetëm në lidhje me vendime për të cilat kanë marrë fund procedurat gjyqësore”. Prandaj, shkelja e të drejtave kushtetuese për një proces të rregullt ligjor mund të pretendohet në këtë gjykatë vetëm pas ezaurimit të të gjitha mundësive që ofron sistemi i padive dhe i apeliave.

Në rastin në shqyrtim, sikundër rezulton nga aktet e dosjes gjyqësore dhe sikundër pranoi edhe vetë kërkuesi, ky i fundit, pretendimin e parashtruar në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese se trupi gjykues që e ka gjykuar çështjen nuk është formuar sipas ligjit (neni 35 i Kodit të Procedurës Civile), nuk e ka ngritur në asnjë instancë të gjyimit, dhe për rrjedhojë, asnjëra nga gjykatat nuk është shprehur për këtë pretendim.

Ndodhur para këtij fakti, Gjykata Kushtetuese vlerëson se në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës, mbrojtja kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, nënkupton jo vetëm ezaurimin e të gjitha mundësive që ofron sistemi i padive dhe i aplikimeve, por edhe konsumimin, si rregull, para gjykatave të sistemit gjyqësor të çdo pretendimi ligjor që parashtrohet si shkak shfuqizimi në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese. Përjashtim nga ky rregull mund të bëhet në rastet kur Gjykata Kushtetuese gjen shkaqe të arsyeshme në përputhje me Kushtetutën dhe Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut.

Nisur nga ky kuptim, si dhe nga rasti konkret ku evidentohet që kërkuesi nuk ka pasur asnjë pengesë për të parashtruar pretendimin mbi përbërjen e trupit gjykues në gjykatat e sistemit gjyqësor, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se ky pretendim i ngritur vetëm para kësaj Gjykate nuk mund të shqyrtohet e për pasojë, nuk mund të shërbejë si shkak për shfuqizimin e vendimeve gjyqësore të atakuara në kërkesë.

Kërkuesi ka pretenduar se Gjykata e Lartë, duke prishur vendimin e gjykatës së apelit, ka vepruar në shkelje të nenit 472 të Kodit të Procedurës Civile, pasi shkaqet e parashtruara në rekurs nuk kishin të bënin as me zbatimin e ligjit material, as me zbatimin e ligjit procedural, por vetëm me vlerësimin e provave. Gjykata Kushtetuese, gjatë shqyrtimit të çështjes, konstaton se Gjykata e Lartë e ka prishur vendimin e gjykatës së apelit, pasi ka arritur në përfundimin se ka zbatuar gabim ligjin si në aspektin material, ashtu dhe atë procedural.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, duke arsyetuar rreth qëndrimit të gabuar të mbajtur nga gjykata e apelit, ka pranuar se kjo gjykatë ka vepruar në kundërshtim me parimin bazë të parashikuar nga neni 20/2 i Kodit të Procedurës Civile, sepse nuk e ka mbështetur vendimin e saj në të gjitha provat e administruara gjatë gjyimit. Po ashtu, ajo ka pranuar se gjykata e apelit ka gabuar dhe për faktin se nuk e ka mbështetur vendimin e saj në vendimin gjyqësor të datës 29.12.1956, me të cilin kërkuesi pretendon se e ka fituar pronësinë. Veç këtyre, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vënë në dukje, me të drejtë, se gjykata e apelit nuk ka arsyetuar qëndrimin e kundërt për provat e administruara në gjykimin e shkallës së parë para se të rrëzonte pretendimin e të paditurve.

Pra, nga këto dhe në të tjera argumente që gjejnë pasqyrim në vendimin e Gjykatës së Lartë, Gjykata Kushtetuese nuk konstaton që Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në dhënien e vendimit të tij të jetë bazuar në vlerësimin apo rivlerësimin e provave të administruara.

Duke vendosur prishjen e vendimit nr.663, datë 26.5.2003 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe duke lënë në fuqi vendimin nr.2352, datë 26.5.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, nuk ka gjykuar çështjen në fakt. Ai ka vepruar konform shkronjës “b” të nenit 485 të Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilit Kolegji Civil apo Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë të drejtë të vendosin prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit. Ky qëndrim nuk ka asgjë të përbashkët me praktikën e kolegjit civil që kërkuesi i është referuar, sepse në atë rast Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur prishjen e

vendimit të gjykatës së apelit dhe gjykimin e çështjes në fakt. Gjykata Kushtetuese nuk konstaton që Gjykata e Lartë të ketë zhvilluar një proces të parregullt ligjor dhe çmon kështu se edhe ky pretendim nuk mund të merret parasysh.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131/f e 134 të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

VENDIM Nr.10, datë 9.5.2005

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergj Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Vjollca Meçaj	Anëtare e “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 9.2.2005, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.15 Akti që i përket:

KËRKUES: ILIR E NAFIJE NOGA, përfaqësuar nga avokat Baftjar Rusi, me prokurë.

SUBJEKTI I INTERESUAR: HANE TOLA, përfaqësuar nga avokat Vladimir Gërmenji, me prokurë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetuese i vendimeve nr.557, datë 22.10.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë; nr.556, datë 30.4.2003 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.689, datë 2.4.2004 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Kërkesit kanë pretenduar se vendimet e lartpërmendura janë rezultat i zhvillimit të një procesi të parregullt ligjor, që konsiston në këto drejtime:

- Procesi gjyqësor nuk është zhvilluar nga një gjykatë kompetente me trup gjykues, por nga një gjyqtar i vetëm. Në këtë mënyrë janë shkelur paragrafi i parë i nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 6 i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

- Gjykata e rrethit ka vepruar në kundërshtim me nenin 35 shkronja “a” të Kodit të Procedurës Civile sepse nuk ka bërë vlerësimin e padisë. Nëse do të kishte përcaktuar atë sipas përmbajtjes së ligjit, çështja duhej gjykuar nga një gjykatë e përbërë me një trup gjykues.

- Gjykata nuk ka përcaktuar drejt ndërgjyqësinë duke mos thirrur në gjykim të gjithë personat madhorë, pasi kemi të bëjmë me një pasuri të fituar nga ligji nr.7501, datë 19.7.1991 “Për tokën bujqësore”.

- Gjykata e apelit, që ka riçelur shqyrtimin gjyqësor me kërkesë të paditësit, nuk ka krijuar

mundësinë për të kundërshtuar provat që paraqiti ai.

- Gjykata e Lartë duhej ta kalonte çështjen për gjykim, pasi i kemi parashtruar disa probleme ligjore.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fehmi Abdiu, përfaqësuesin e kërkuesve që kërkoi pranimin e kërkesës, përfaqësuesin e subjektit të interesuar që kërkoi rrëzimin e saj, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, me vendimin nr.557, datë 22.10.2002, ka rrëzuar kërkesën e paditëses Hane Tola, me objekt pjesëtim të pasurisë trashëgimore.

Mbi ankimin e saj, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.556, datë 30.4.2003, duke vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së rrethit, ka pranuar padinë dhe ka lejuar pjesëtimin e sipërfaqes së tokës prej 13.644 m² ndërmjet paditëses Hane Tola dhe të paditurve Nafije e Ilir Noga, duke marrë e para ½ pjesë dhe të paditurit nga ¼ pjesë.

Mbi rekursin e bërë nga të paditurit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (dhoma e këshillimit), me vendimin nr.689, datë 2.4.2004, ka vendosur mospranimin e tij.

Në kundërshtim me sa kanë pretenduar kërkuesit gjatë shqyrtimit të çështjes në Gjykatën Kushtetuese, është konstatuar se ata nuk i kanë shterur, sipas ligjit, të gjitha mjetet ligjore në interes të tyre. Nga materialet e ndodhura në dosjen gjyqësore, gjatë shqyrtimit të kërkesës, ka rezultuar se kërkuesit, megjithëse kanë ushtruar rekurs përpara Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, në të vërtetë, në të nuk kanë parashtruar asnjërin nga pretendimet e paraqitura në ankimin kushtetues drejtuar Gjykatës Kushtetuese. Ndryshe nga sa kanë parashtruar para kësaj Gjykate, në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë, kërkuesit kanë pretenduar se gjykata e apelit ka keqinterpretuar aktet ligjore dhe nënligjore lidhur me tokën bujqësore e se ka zbatuar në mënyrë të gabuar vendimin nr.452, datë 17.10.1992 të Këshillit të Ministrave “Për ristrukturimin e ndërmarrjeve bujqësore”.

Nga përmbajtja e akteve të gjykimit në gjykatën e rrethit, të apelit dhe në rekursin e paraqitur përpara Gjykatës së Lartë, është konstatuar se kërkuesit, pretendimet për përcaktimin e drejtë të vlerës së objekteve të padisë, për gjykatën kompetente dhe për formimin e ndërgjyqësisë, nuk i kanë ngritur para gjykatës së apelit dhe as para Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, e për rrjedhojë, asnjëra prej tyre nuk është shprehur për këto pretendime.

Sipas nenit 131/f të Kushtetutës, individit mund të paraqesë ankim para Gjykatës Kushtetuese për shkeljen e të drejtave kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shterur të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e tyre.

Lidhur me këtë, Gjykata Kushtetuese, në vendimin e saj nr.10, datë 2.4.2003, ka pranuar se “Sipas kuptimit të nenit 131/f të Kushtetutës, mbrojtja kushtetuese ka një funksion përfundimtar që do të thotë se mund të aplokohet vetë në lidhje me vendime për të cilat kanë marrë fund procedurat gjyqësore. Prandaj, shkelja e të drejtave kushtetuese për një proces të rregullt ligjor mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pas ezaurimit të të gjitha mundësive që ofron sistemi i padive dhe i aplikimeve”.¹

Veç kësaj, në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës, mbrojtja kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, nënkupton jo vetëm ezaurimin e të gjitha mundësive që ofron sistemi i padive dhe i aplikimeve, por edhe konsumimin si rregull para gjykatave të sistemit gjyqësor të çdo pretendimi ligjor që parashtrohet si shkak shfuqizimi në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese. Përfundimi nga ky rregull mund të bëhet në ato raste kur Gjykata Kushtetuese, gjatë shqyrtimit të çështjes, gjen shkaqe të arsyeshme në përputhje me Kushtetutën dhe Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Nisur nga ky kuptim, si dhe nga rrethanat e rastit konkret që kërkuesit nuk kanë pasur asnjë pengesë për të parashtruar pretendimet e lartpërmendura në gjykatat e sistemit gjyqësor, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se ky pretendim, i ngritur vetëm para kësaj Gjykate, nuk mund të shërbejë si shkak për shfuqizimin e vendimeve të atakuara në kërkesë.

¹ Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.10, datë 2.4.2003

Përsa sipër, kërkesa e kërkuësve duhet të rrëzohet si e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

VENDIM

Nr.22, datë 4.5.2005

**PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE, NGA
SHOQËRIA “WONDER - POWER” SHA**

Në mbështetje të neneve 9, 8, pika 2 germa b, dhe 26 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 4.5.2005, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “WONDER – POWER” sh.a., për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për HEC-in Bogovë,

VENDOSI:

1. Çmimi i shitjes së energjisë elektrike të prodhuar nga shoqëria “WONDER - POWER” sh.a., për HEC-in Bogovë, për periudhën 1.1.2005–31.12.2005, të jetë 5,85 lekë/kWh.
Ngarkohet shoqëria “WONDER - POWER” sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema**

VENDIM

Nr.23, datë 4.5.2005

**PËR VENDOSJEN E GJOBËS NDAJ SHOQËRIVE “ESSEGEI- SHQIPËRI-SMOKTHINA”
SHPK DHE “HYDROELECTRIC COMPANY OF ALBANIA” SHPK**

Në mbështetje të nenit 9 dhe nenit 64 pika 1 germa a të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i Bordi Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 4.5.2005, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Departamenti i Licencave dhe i Monitorimit dhe Departamenti i Tarifave dhe i Çmimeve, lidhur me mospërmbushjen e detyrimeve ligjore nga ana e kompanive gjeneruese “Essegei- Shqipëri-Smokthina” dhe “Hydroelectric Company of Albania” sh.p.k.,

VENDOSI:

1. Të dënojë me gjobë shoqërinë “Essegei-Shqipëri-Smokthina” sh.p.k., në shumën prej 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.
 2. Të dënojë me gjobë shoqërinë “Hydroelectric Company of Albania” sh.p.k., në shumën prej 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.
 3. Ngarkohen Departamenti i Administrimit, i Financës dhe i Burimeve Njerëzore, si dhe Departamenti i Licencave dhe i Monitorimit për ndjekjen e ekzekutimit të këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema**

SHPALLJE KËRKESE PËR SHPRONËSIM

Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit shpall kërkesën “Për shpronësimin e pronarëve, pasuritë pronë private të të cilëve preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Qafë-Kashar-Rinas”.

Subjekti kërkues i këtij shpronësimi është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

Me anë të këtij publikimi në shtyp, kërkohet të vëmë në dijeni personat që preken nga ky shpronësim.

Vënia në dijeni konsiston në sipërfaqen që shpronësohet dhe masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Transportit dhe të Telekomunikacionit, për personat sipas listës emërore të mëposhtme.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E TRANSPORTIT E TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA JURIDIKE
QARKU TIRANE , QARKU DURRES

Lista e pronareve qe shproneshohen per shkak te ndertimit te segmentit rrugor
Qafe Kashar - Rinas

Lloji i pasurise se paluajtshme: Toke Ate, truall, kulture bujqesore dhe objekte (1-119)														
Nr.	Emër	Pronari	Mbiemri	Pas.	Nr. sip. Ate m2	Emri i lek/m2	Vlera leke	Sip. Truall m2	Vlera k.b. leke	Objekte	Vlera lekem2	Vlera leke	Totali leke	Shënimet
1	Dritan	Murati		135/11	1050	929	975450		9712			985162	C.P. HTR dhe K Pronesia	
2	I pidentifikuar			135/10	1886	929	1752094		17445			1769539	konfirmim nga komuna	
3	Pirro	Zoto		134/23	144	929	133776		1332			135108	konfirmim nga komuna	
4	I pidentifikuar			134	891	929	827739		8242			835981		
5	Rapush Ymer	Murati		134/24	1860	929	1727940		17205			1745145	C.P. HTR dhe K Pronesia	
6	Arben	Murati		134/28	2632	929	2630928		26196			2657124	konfirmim nga komuna	
7	Arben	Murati		134/32	480	929	445920		4440			450360	C.P. HTR dhe K Pronesia	
8	I pidentifikuar				1620	929	1504980		14985			1619965		
9	I pidentifikuar			89/5	3800	929	3530200		35150			3665550		
10	Kuljim Shefqet	Valisi		89/3	2000	929	1858000		18500			1876500	C.P. HTR dhe K Pronesia	
11	I pidentifikuar				8370	929	7775730		77422			7863162		
12	Zydi	Vasili		545/15	2150	929	1997350		19888			2017238	konfirmim nga Z Rr P P	
13	Hasan	Morina		545	1205	929	1119445		11146			1130591	konfirmim nga komuna	
14	Reshit	Devishi		545/10	1560	929	1449240		14430			1463670	pretenden Qamil Morina	
15	Jonuz	Haka		544/7	220	929	204380		2035			206415	konfirmim nga komuna	
16	Besnik	Haka		544/6	830	929	771070		7678			778748	konfirmim nga komuna	
17	Hasan	Haka		544/5	1875	929	1741875		17344			1759219	konfirmim nga komuna	
18	Adem	Haka		544/5	751	929	697679		6947			704626	konfirmim Z Rr P P	
19	Osman	Haka		544/5	751	929	697679		6947			704626	konfirmim Z Rr P P	
20	Mustafa	Haka		544/5	751	929	697679		6947			704626	konfirmim Z Rr P P	

21	Aslan	Shera	544/2/1	1980	929	1839420	18315	1857735	pretendon Perparim Jaupi
22	Perparim	Jaupi	544/1/1	1632	929	1516128	15096	1531224	pretendon Abdulla Shehi
23	Adem	Devishi	471/19	1192	929	1107368	11026	1118394	konfirmim nga komuna
24	Ramazan	Devishi	471/20/1	84	929	78036	777	78813	konfirmim nga komuna
25	Adem	Devishi	471/25	112	929	104048	1036	105084	konfirmim nga komuna
26	Ramazan	Devishi	471/26	1268	929	1177972	11729	1189701	konfirmim nga komuna
27	Adem	Mici	471/27	50	929	46450	462	46912	konfirmim nga komuna
28	Fiqiri	Mici	471/28	1744	929	1620176	16132	1636308	konfirmim nga komuna
29	Ramazan	Mici	479/6	306	929	284274	2830	1358104	plotesim dokumentacioni
30	Adem	Mici	479/5	466	929	432914	4310	2068224	plotesim dokumentacioni
31	Fiqiri	Mici	479/4	462	929	429198	4274	2050472	plotesim dokumentacioni
32	Vath	Boka	479/3	594	929	551826	5484	2636320	plotesim dokumentacioni
33	Miftar	Boka	479/2	594	929	551826	5484	2636320	plotesim dokumentacioni
34	Ramazan	Boka	479/1	594	929	551826	5484	2636320	plotesim dokumentacioni
35	Jakup	Haka	480/3	361	929	335369	3339	338708	konfirmim Z. Rr P P
36	Xhemal	Haka	480/3	766	929	711614	7085	718659	konfirmim Z. Rr P P
37	Sherif	Haka	480/3	901	929	837029	8334	845563	konfirmim Z. Rr P P
38	Shefqet	Haka	480/	200	929	185900	1850	187650	konfirmim nga komuna
39	Hasan	Morina	480/2	1955	929	1816195	18084	1834279	konfirmim Z. Rr P P
40	Kujtim	Osmami	480/2			0		0	konfirmim Z. Rr P P
41	Rustem	Daut	307/8	150	929	139350	1388	140738	konfirmim nga komuna
42	Halim	Ahmet	307/6	1959	929	1819911	18121	1838022	konfirmim Z. Rr P P
43	Gemal	Mora	307/6	1959	929	1819911	18121	1838032	konfirmim Z. Rr P P
44	Abedin	Mora	307/6	1959	929	1819911	18121	1838032	konfirmim Z. Rr P P
45	Sefer	Anza	209/8	96	929	89184	888	90072	C.P. HTR dhe K.Pronesia
46	Ramazan	Dursati	209/9	195	929	181155	1804	182953	pretendon Ismail Mora
47	Vath	Boka	209/7	540	929	501690	4995	506655	pretendon Ahmet Boka
48	i palidentifikuar	Boka	209/6	390	929	362310	3608	365918	pretendon Ramadan Boka
49	Mustafa	Boka	209/7	680	929	631720	6290	638010	
50	Mustafa	Boka	209/6	476	929	442204	4403	446607	pretendon Vath Boka
51	Ahmet	Boka	209/5	884	929	821236	8177	829413	pretendon Vath Boka
		Boka	209/4	748	929	654892	6919	701811	pretendon Ramadan Boka

52	Daut	Mara	209/3	1020	929	947560	9435					pretendon Ramadan Mici
53	Ismail	Mara	209/2	893	929	629597	8260					pretendon Selfer Durishti
54	I pidentifikuar		209/1	96	929	88184	888					
55	Agim	Cervishi	210/6	100	929	92900	925					pretendon Ruzhd Dervishi
56	Hajdar	Cervishi	210/8	2055	929	1909065	19009					konfirmim nga komuna
57	Gani	Sula	211/12	2784	929	2586336	25752					Proces regjistrimi
58	Islam	Mustafa	211/24	504	929	468216	4662					C.P. HTR dhe K.Pronesia
59	Haki	Shera	120/19	735	929	682815	6799					konfirmim Z. Rr. P. P
60	Shaban	Shera	120/23	1978	929	1937562	18296					C.P. HTR dhe K.Pronesia
61	Lumturi	Shera	120/22	504	929	468216	4662					C.P. HTR dhe K.P.
62	Shaban	Shera	120/22	504	929	468216	4662					C.P. HTR dhe K.P.
63	Shqiponje	Pipiko	120/22	504	929	468216	4662					C.P. HTR dhe K.P.
64	Baki	Lushi	120/17	720	929	668880	6660					pretendon Lutifje Shera
65	I pidentifikuar		120/15	1161	929	1078569	10739					
66	Shefqet	Muka	13	375	929	346375	3469					konfirmim nga komuna
67	Rasim	Huli	13	1050	929	975450	9712					konfirmim nga komuna
68	Musa	Huli	13			0						
69	Ramadan	Huli	13			0						
70	Gazim	Muka	13/18	2070	929	1923030	19148					plotesim dokumentacioni
71	Baki	Muka	13/19	2184	929	2028936	20202					pretendon Liman Shera
72	Fadi	Shera	13	468	929	434772	4329					pretendon Baki Muka
73	Dalip	Hoxha	56	125	929	116125	1156					konfirmim nga komuna
74	Latif	Hoxha	56			0						pretendim pronesia
75	Latif	Elbelia	61/1	3835	929	3562715	35474					konfirmim Z. Rr. P. P
76	I pidentifikuar	Elbelia	29	5254	929	4880966	48600					konfirmim nga komuna
77	Besim	Caka	25	1200	929	1114800	11100					konfirmim nga komuna
78	Bejram	Caka	156/	1334	929	1239288	12340					konfirmim nga komuna
79	Ibrahim	Caka	156/2	1771	929	1645259	16382					konfirmim nga komuna
80	I pidentifikuar	Caka	156/1	3105	929	2884545	28722					konfirmim nga komuna
81	I pidentifikuar		3	209	929	194161	1933					konfirmim nga komuna
82	Agim	Disha	1	4820	929	4570680	45510					konfirmim nga komuna
			156/11	4200	929	3901600	38850					konfirmim nga komuna

83	Rexhep	Demirxhu	155/1	1488	929	1382352	13764	1396116	konfirmim nga komuna
84	Muhamet	Demirxhu	155/1	3150	929	2926350	29138	2955488	konfirmim nga komuna
85	i pidentifikuar		94/1	460	929	427340	4255	431855	
86	i pidentifikuar		94/2	812	929	754348	7511	761859	
87	i pidentifikuar		94/3	390	929	362310	3608	365918	
88	i pidentifikuar		94/4	768	929	713472	7104	720576	
89	i pidentifikuar		94/5	1992	929	1850568	18426	1868994	
90	Ali	Carungu	84	2835	929	2633715	26224	2659839	konfirmim nga komuna
91	i pidentifikuar		84	5818	929	5404922	53816	5487738	
92	Shaqir	Mezini	84	2450	929	2276050	22662	2298712	Proces regjistrimi
93	Muhamet	Xhehollari	84	2010	929	1867280	18592	1895892	Proces regjistrimi
94	Skender	Kulli	42/2/14	1440	929	1337760	13320	1351080	Proces regjistrimi
95	Sadik	Kulli	42/2/13	936	929	869544	8658	878202	Proces regjistrimi
96	Shaban	Kulli	42/2/12	408	929	379032	3774	382806	Proces regjistrimi
97	Perrit	Kulli	42/2/11	600	929	557400	5550	562950	Proces regjistrimi
98	Hajdar	Kulli	42/2/10	336	929	312144	3108	316252	Proces regjistrimi
99	Ibrahim	Pajoni	42/2/9	1012	929	940148	9361	949509	Proces regjistrimi
100	Abdulla	Alushi	42/2/8	1880	929	1746520	17390	1763910	Proces regjistrimi
101	Bashkim	Nega	42/2/7	2160	929	2008640	19980	2026620	Proces regjistrimi
102	Esat	Shehu	42/2/6	1368	929	1270872	12654	1283226	Proces regjistrimi
103	i pidentifikuar		42/10	100	929	92900	925	93825	
104	Ramazan	Prini	42/9	171	929	158859	1582	160441	Proces regjistrimi
105	Hajije	Mullaj	42/5	4529	929	4207441	41893	4249334	Proces regjistrimi
106	Hamdi	Mila	58/1	1280	929	1189120	17408	1206528	Konfirmim ZRPP
107	Ramiz	Kullasi	57/1	24	929	22286	326	22622	Konfirmim ZRPP
108	Shkelqim	Kullasi	57/2	108	929	100332	1469	101801	Konfirmim ZRPP
109	Shaqet	Kullasi	57/3	1126	929	1046054	15314	1061368	Konfirmim ZRPP
110	Hamit	Visha	57/4	630	929	585270	5868	593838	Konfirmim ZRPP
111	Perrit	Visha	57/5	675	929	627075	9180	636255	Konfirmim ZRPP
112	Ibrahim	Visha	57/6	900	929	836100	12240	848340	Konfirmim ZRPP
113	Clirim	Kurti	56	4350	929	4041150	59160	4100310	Konfirmim ZRPP
114	Naim		55/12	504	929	468216	6854	476070	Konfirmim ZRPP

116	Xhavit	Besim	Kurti	5515	966	929	897414	13138			910552	Konfirmim ZRPP
116	Xhavit	Besim	Kurti	5519			0	988	objekt		0	proces vleresimi
117	i padentifikuar			551			0	132	objekt		0	proces vleresimi
118	i padentifikuar				1155	929	1072995	10684			1083679	Proces regjistrimi
119	Jeme	Hamdi	Kullaj	202	2815	929	2615135	38284			2853419	C.P. HTR dhe K.Pronesia
		SHUMA			157627		146435483	1170	1516245	13025046	160976774	
Mbyllet me numer rendor 119												

Shenim : Brenda afatit ligjor 15 dite pas publikimit, te gjitha pronaret qe jane me shenime proces regjistrimi, konfirmim nga zyra e regjistrimi, konfirmim nga komuna, te paraqesin dokumentacionin e nevojshem ligjor (certifikate, harte treguese e karteje) te noterizuara, prane sektorit te shpronесimeve ne Ministrine e Transportit dhe Telekomunikacionit.

KËRKESË

Shtetёsja Nexhmije Sopoti (Cakrri) banuese nё fshatin Brezhdan tё Komunёs Qendёr Tomin, kёrkon shpalljen tё vdekur tё babait tё saj Ali Cakrri i datёlindjes 1928.

KËRKUESE
Nexhmije Sopoti (Cakrri)

Ndreqje gabimi

“Në nenin 80 të ligjit nr.9341, datë 10.1.2005 (botuar në Fletoren Zyrtare nr.1 janar 2005), në nenin e shtuar 109/5 hiqet numërtimi “2” dhe numërtimi “3” ndryshohet në “2”.

Fletorja Zyrtare gjendet:

Duke u abonuar për çdo vit pranë:

- çdo njësie postare të qyteteve;

- Qendrës së Publikimeve Zyrtare:

Bulevardi Zhan d'Ark, pranë ish-ekspozitës "Shqipëria Sot".

Tel: 042 555 63; 267 468

Për çdolloj informacioni, shihni faqen e internetit në adresën:

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

BOTIMET:

1. KUSHTETUTA (edhe anglisht)
2. KODI I PROCEDURËS CIVILE
3. KODI I PROCEDURËS PENALE
4. KODI PENAL
5. KODI I PUNËS
6. KODI I FAMILJES
7. KODI CIVIL
8. KODI RRUGOR DHE LIGJI PËR TRANSPORTIN
9. KODI ZGJEDHOR (i azhurnuar)
10. KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE
11. DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

1. PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT
2. PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK
3. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL
4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SISTEMIN E DREJTËSISË
5. PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE

DOLI NGA SHTYPI:

TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004

TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004

Doli nga shtypi më 20.5.2005

Tirazhi: 4300 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2005

Çmimi 150 lekë